



Gonzato: Fuqizimi i grave dhe rruga drejt BE, procese jetike për Shqipërinë

Faqe 2



Aplikacionin Agritourism AL në Google Play Store dhe App Store

Faqe 2



BE i ofroi Shqipërisë mbi 500 milionë euro ndihmë financiare vetëm në 2021-2024

Faqe 11



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit dhjetor 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 500
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

PËRAFRIMI ME KAPITUJT E BE-SË: NJË SFIDË DHE NJË MUNDËSI

ROLI I PROGRAMIT GLOBAL PËR CILËSINË DHE STANDARDET NË MBËSHTETJEN E SHQIPËRISË DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

Integrimi Evropian kërkon përputhjen me standardet e BE-së në sektorë kyç si zhvillimi rural, siguria ushqimore dhe lëvizja e lirë e mallrave. Programi GQSP po mbështet fermerët dhe NVM-të për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe qasjen në tregjet globale

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

ALBANIA

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Rama: Shkolla e Hoteleri-Turizmit me standardet e Lozanës, mundësi e shkëlqyer për gjeneratën e re të profesionistëve

Faqe 5

BOTIME TË REJA

"Bimët dhe Shqiptarët"
Një prurje shkencore autentike

Shefqet Meko, Minneapolis

TEMA TË DITËS

Faqe 6

MJEDIS

"Fshatrat, në rritje me agroturizmin si alternativë"
- Sokol Duma: Të rrisim investimet në alpe pa prekur zonat e mbrojtura

Faqe 5

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe Redaksia e Gazetës "Agrobiznesi" ju Uron Gëzuar Vitin e Ri 2025 dhe Mbarësi në familjet tuaja!

- Shqipëri-Poloni, parafirmoset marrëveshja për njohjen e pensioneve Fq.2
- Dita e tokës mëmë - Promovohen prodhimet bio, rreziku i zhdukjes së varieteteve bimore Fq.4
- Vlorë, vijon puna për kalimin e tokës bujqësore nga përdorim, në pronësi Fq.4
- Një artizane e përkushtuar, punimet e artizanesh të preferuara në çdo stinë Fq.5
- Kalendari bujqësor, muaji janar 2025 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

TEMA TË DITËS

Aplikacionin Agritourism AL në Google Play Store dhe App Store

Mbështetje zhvillimit të qendrueshëm të Agroturizmit

Këtë javë u nënshkrua marrëveshja midis Shoqatës së Agroturizmit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes dhe qëndrueshmërisë së platformave të agroturizmit

shqiptar.

Këto platforma të përditësuara ofrojnë për vizitorët vendas dhe të huaj mbi 200 oferta agroturistike dhe elemente të tjera të turizmit rural, si ferma, kulla, kampe, kantina vere, artizanë, prodhues lokalë, ture

agroturistike, etj.

Ju ftojme të shkarkoni aplikacionin Agritourism AL në Google Play Store dhe App Store, si dhe të vizitoni faqen në internet agrotourism.gov.al për të shijuar çdo aspekt të Shqipërisë rurale.



Platformat Agritourism AL drejt qëndrueshmërisë



Parku Kombëtar i Vjosës, zyrë administrimi në Tepelenë, Qeveria miraton vendimin



Parku Kombëtar i Vjosës do të menaxhohet nga një zyrë e posaçme e cila do të ngrihet në Tepelenë. Sipas VKM-së së

miratuar këtë të premtë zyra do të financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit

në fuqi. Ndërkohë gjithë të ardhurat që mblihen nga vizitorët dhe përdoruesit e tjerë të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" do të derdhen në Buxhetin e Shtetit. Ndër funksionet më kryesore të kësaj zyre do të jenë: hartimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit, projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore si edhe kryerja e punimeve të mirëmbajtjes dhe koordinimi i punës me institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë. Në vendimin e qeverisë janë përcaktuar edhe kriteret për zgjedhjen e drejtuesit të kësaj zyre si edhe kompetencat dhe detyrat e tij.

Shitja e gjelave për fundvit, tregtarët në Elbasan ulin çmimin në 800 lekë kg

Në tregun e shpendëve në Elbasan ka nisur shitja e gjelave të detit. Këtë vit tregtarët janë kujdesur të kenë një çmim më të ulët se vitin e kaluar ku aktualisht një kg kush-ton 800 lekë. Por shqetësim për ta mbetën produktet e ardhura nga jashtë të cilat sipas tyre janë më çmime dhe cilësi më të ulët.

Ndonëse këtë vit ka ulje të çmimeve për gjelin e detit, pensionistët sërish hasin vështirësi në blerjen e tij.

Nga vëzhgimet rezultojnë se këtë vit në tregun e shpendëve në Elbasan ka ulje çmimesh

për të plotësuar kërkesat e konsumatorëve



Skema e re e Granteve 2025 për startup-et, Ibrahimaj: Tre kategori përfituese, kriteret

Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj, në një intervistë televizive tha se për skemën e re të granteve 2025 për startup-et është vënë në dispozicion një fond prej 300 milionë lekësh.

Ibrahimaj tha se skema synon mbështetjen dhe fuqizimin e nis-mave inovative. Ajo nënvizoi se aplikimet janë të hapura deri në datën 30 dhjetor 2024, ku pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të bëhen pjesë e transformimit të ekosistemit të startup-eve në Shqipëri.

Ministrja renditi 3 kategoritë që mund të aplikojnë për grantet. "E rëndësishme është që ndërmarrjet në Shqipëri të kenë qasje drejt qëndrueshmërisë së ambientit dhe inovacionit dhe digjitalizimit. Në strategjinë tonë të mbështetjes së sipërmarrjes inovative kemi përcaktuar disa fusha që janë prioritare, ato janë bazuar në një tjetër strategji në strategjinë smart specialization. Këtu është turizmi, bujqësia, energjia, pra sektorë të cilët janë

prioritarë në politikat e qeverisë shqiptare", u shpreh Ibrahimaj.

"Në grant mund të aplikojë çdo individ i cili ka një ide, çdo biznes që ka filluar të zhvillojë një produkt apo shërbim inova-

totip, mund të financohesh deri në nivelin 1 mln e 500 mijë lekë ose 15 mijë euro. Është financim 100%.

Fasha e dytë shkon deri në 45 mijë euro dhe e tretë deri



90 mijë euro. Ndërkohë që do të ketë edhe disa shpenzime që janë në bashkëfinancim deri në nivelin 85% , 75%...I kemi nxitur aplikuesit që të aplikojnë në bashkëpunim me lehtësues. Lehtësues janë ato kompani që kanë për qëllim trajnimin dhe mbështetjen e startupeve", nënvizon Ibrahimaj.

Gonzato: Fuqizimi i grave dhe rruga drejt BE, procese jetike për Shqipërinë

Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Silvio Gonzato, foli në një takim me gratë se angazhimi për barazinë gjinore dhe fuqizimi i tyre në ro-

drejt anëtarësimit në BE.

"BE mbetet e vendosur në angazhimin e saj për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si shtylla të rëndësishme të proces-



let vendimmarrëse janë procese jetike për vendin dhe rrugën

it të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Sigurimi i mundësive të

barabarta për gratë, veçanërisht në politikë dhe vendimmarrje, është thelbësor për përparimin dhe prosperitetin e vendit dhe për një shoqëri kohezive ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre mund të përmbushin aspiratat e tyre", u shpreh ai.

Sipas ambasadorit Gonzato, "fuqizimi i grave dhe rruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, jo vetëm që janë të ndërlidhura, por janë jetike për progresin, stabilitetin dhe prosperitetin e ardhshëm të Shqipërisë. Arsimi, kujdesi shëndetësor dhe pjesëmarrja politike janë vetëm disa fusha ku përfshirja e grave mund të bëjë një ndryshim transformues".

Shqipëri-Poloni, parafirmoset marrëveshja për njohjen e pensioneve

Shqipëria dhe Polonia parafirmosin marrëveshjen kuadër në fushën e sigurimeve shoqërore.

Raundi i tretë i negociatave që u zhvillua në Tiranë në datat 11-13 nëntor u drejtua nga zëvendësministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Olta Manjani dhe për palën polake nga nënsekretari i shtetit të Ministrisë së Punës, Familjes dhe Çështjeve Sociale, Sebastian Gayewski.

Përmes kësaj marrëveshjeje, qytetarët shqiptarë sigurojnë një sërë përfitimesh, si: pensionin e pleqërisë, përfitimet e



barrëlidjes, pensionin familjar, atë të invaliditetit etj..

Qytetarët do të përfitojnë nga

bashkimi i periudhave kontributive, duke siguruar që të mos humbasin vitet e tyre të punës.

PËRAFRIMI ME KAPITUJT E BE-SË: NJË SFIDË DHE NJË MUNDËSI

ROLI I PROGRAMIT GLOBAL PËR CILËSINË DHE STANDARDET NË MBËSHTETJEN E SHQIPËRISË DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

Integrimi Evropian kërkon përputhjen me standardet e BE-së në sektorë kyç si zhvillimi rural, siguria ushqimore dhe lëvizja e lirë e mallrave. Programi GQSP po mbështet fermerët dhe NVM-të për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe qasjen në tregjet globale

Përafrimi me Kapitujt e BE-së: Një Sfidë dhe Një Mundësi

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian kërkon përputhjen e standardeve kombëtare me rregulloret e BE-së në shumë fusha të rëndësishme. Kapitujt 11 (Zhvillimi Bujqësor dhe Rural), 12 (Siguria Ushqimore, Politikat Veterinare dhe Fitosanitare) dhe 1 (Lëvizja e Lirë e Mallrave) janë thelbësorë për arritjen e këtij objekti. Programi Global për Cilësinë dhe Standardet (GQSP), i mbështetur nga UNIDO dhe Qeveria Zvicerane, ka ndihmuar fermerët, SME-të dhe institucionet kombëtare të harmonizojnë praktikën e tyre me standardet ndërkombëtare. Ky angazhim ka pasur një ndikim të rëndësishëm jo vetëm në zhvillimin ekonomik, por edhe në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet evropiane.



Zhvillimi Rural dhe Mbështetja për Fermerët

Shqipëria përballet ende me sfida të mëdha në zhvillimin bujqësor dhe rural, përfshirë kufizimet e importit, tarifën dhe aksesin e kufizuar në tregjet ndërkombëtare. Për të adresuar këto sfida, përafrimi me standardet ndërkombëtare mbetet thelbësor, duke ndihmuar produktet bujqësore shqiptare të reduktojnë barrierat tregtare dhe të bëhen më konkurruese. Programi GQSP ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e komuniteteve rurale për të përmirësuar standardet ndërkombëtare, duke hapur potencialisht mundësi të reja tregtare dhe duke përmirësuar kushtet për prodhuesit me të ardhura të ulëta.



Certifikimi për produkte organike ka filluar të krijojë mundësi për hyrjen në tregje të specializuara, megjithëse varësia nga prodhimet tradicionale mbetet ende një sfidë. Fermerët po punojnë për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe për të përmirësuar kërkesat e tregjeve globale, duke synuar të arrijnë çmime më të larta në tregje më të sofistikuar. Përmes mbështetjes së GQSP, ka nisur përmirësimi i praktikave të përpunimit, paketimit dhe markimit, me qëllim shtimin e vlerës për produktet shqiptare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tyre.

Programi gjithashtu ka promovuar bujqësinë e qëndrueshme, duke nxitur përdorimin e teknikave që ruajnë burimet natyrore dhe mbështesin qëndrueshmërinë afatgjatë. Certifikimet për bujqësinë organike dhe teknikat miqësore ndaj mjedisit po ndihmojnë disa fermerë të fillojnë përmirësimin e kërkesave për produkte të gjelbra, por është e qartë se nevojiten ende investime dhe përpjekje më të mëdha për të arritur përhapje më të gjerë të këtyre praktikave.


Zgjerimi i aksesit në tregje mbetet një qëllim kryesor. Ndërkohë që janë bërë përparime, puna vazhdon për të ndihmuar fermerët dhe SME-të të integrohen më mirë në rrjetë më të mëdha tregtare. Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së produkteve ka filluar të japë rezultate, duke krijuar një bazë për zhvillimin ekonomik rajonal dhe duke kontribuar në një sektor më të qëndrueshëm në të ardhmen. Pavarësisht këtyre përmirësimeve, mbetet shumë punë për të përmirësuar objektivat afatgjatë

jata dhe për të arritur qëndrueshmërinë e plotë të sektorit.

Siguria Ushqimore si Prioritet Kombëtar

Siguria ushqimore dhe standardet veterinarë e fitosanitare janë kritike për përafrimin e Shqipërisë me rregulloret e BE-së dhe marrëveshjet ndërkombëtare të tregtisë. Këto standarde mbrojnë konsumatorët, mbështesin qëndrueshmërinë bujqësore dhe sigurojnë shëndetin e zinxhirit të furnizimit ushqimor. Rregulloret shqiptare përcaktojnë nivele të pranueshme për ndotësit dhe aditivët në ushqime, duke përbushur kritere rigoroze që garantojnë sigurinë dhe cilësinë e produkteve.

Këto rregullore trajtojnë çështje të rëndësishme si mbetjet e pesticideve, ndotja mikrobiale dhe aditivët kimikë, duke mbrojtur shëndetin e konsumatorëve. Teknikat e duhura të etiketimit, paketimit dhe ruajtjes përmirësojnë më tej standardet ushqimore,



duke kontribuar në një industri të rregulluar dhe të besueshme. Rregulloret për pastërtinë dhe higjienën janë jetike për sigurinë e produkteve ushqimore nga prodhimi deri te shitja. Implementimi i këtyre rregullore mbështetet nga një sistem i fuqishëm auditimesh dhe inspektimesh, të cilat identifikojnë dhe adresojnë rreziqet e mundshme në faza të ndryshme të prodhimit. Inspektimet e rregullta përmirësojnë sigurinë dhe besueshmërinë e zinxhirit ushqimor, duke garantuar që produktet shqiptare të jenë të sigurta dhe konkurruese në tregjet ndërkombëtare.

Lëvizja e Lirë e Mallrave - Çelësi për Eksporte në BE

Lëvizja e lirë e mallrave është një aspekt kritik i integrimit ekonomik të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Megjithatë, për të arritur këtë, Shqipërisë i duhet një infrastrukturë e fuqishme në standardizim, certifikim, metrologji dhe mbikëqyrje tregu. Këto sisteme janë thelbësore për të siguruar që produktet të përbushin standardet e cilësisë, sigurisë dhe rregullatorit për tregtinë ndërkombëtare.

Programi GQSP luan një rol kyç në ndërtimin dhe forcimin e këtyre elementeve të infrastrukturës. Përmes harmonizimit të standardeve shqiptare me ato të BE-së dhe forcimit të kapaciteteve të organeve të vlerësimit të konformitetit, GQSP siguron që produktet shqiptare të jenë konkurruese në tregjet ndërkombëtare.

Forcimi i Infrastrukturës Kombëtare të Cilësisë (QI)

Programi GQSP ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar sistemin e cilësisë në Shqipëri, duke përgatitur institucionet për përputhjen me standardet e BE-së dhe tregjet ndërkombëtare. Përmes një sërë vlerësimesh, janë identifikuar mangësitë dhe janë ndërmarrë veprime për të rritur aftësitë teknike dhe menaxheriale të institucioneve kryesore, si Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), Metrologjia dhe Akreditimi. Për të mbështetur anëtarësimin e plotë të DPS në CEN dhe CENELEC, janë zhvilluar trajnime për ISO 9001, është përmirësuar platforma dixhitale dhe janë përfaqësuar praktikantët më të mira në forume ndërkombëtare si UNECE.

Në fushën e metrologjisë, në bashkëpunim me METAS, është përgatitur një plan strategjik për DPM, duke synuar rritjen e shërbimeve të kalibrimit dhe përmirësimin e ISO/IEC 17065 për certifikimin e produkteve të ambalazuara. Ky progres mbështet harmonizimin me legjislacionin e BE-së dhe

redukon barrierat teknike për tregtinë.

Përmirësimi i Kompetencave të Laboratorëve

Programi ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve teknike të laboratorëve në Shqipëri, të cilët janë kritikë për sigurinë ushqimore dhe përmirësimin e zinxhirit bujqësor. Trajnime të specializuara janë organizuar për ISO/IEC 17025:2017 për institucionet si Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Autoriteti Kombëtar të Ushqimit (AKU), dhe Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), duke u fokusuar në analiza të mbetjeve të pesticideve, metoda të validimit dhe menaxhimin e pajisjeve. Laboratorët kanë përfituar nga zhvillimi i Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë (QMS) dhe asistencës teknike për pajisje të reja, duke përmirësuar aftësinë për të siguruar rezultate të sakta dhe të besueshme.

Këto veprime po përgatitin laboratorët shqiptarë për akreditim ndërkombëtar, duke rritur besueshmërinë e produkteve shqiptare.

Mbështetja për SME-të në Zinxhirët e Vlerës së Bimëve Aromatike e Mjekësore dhe Fruta-Perimeve

GQSP ka pasur një fokus të madh në mbështetjen e SME-ve dhe fermerëve në sektorët e bimëve aromatike dhe mjekësore (BAM) dhe frutave dhe perimeve (F&P). Trajnime të shumta janë ofruar për adoptimin e standardeve si GlobalG.A.P., ISO 9001 dhe certifikimeve organike, duke u përqendruar në praktikat e qëndrueshme dhe gjurmueshmërinë e produkteve. Programet kanë ndihmuar fermerët dhe SME-të të rrisin cilësinë e produkteve, të plotësojnë kërkesat ndërkombëtare dhe të kenë akses më të mirë në tregjet evropiane.

Përmes krijimit të Grupeve të Veprimit Vendor (GVV) në rajone të ndryshme si Shkodër, Korçë, Sarandë Berat, Sarandë dhe Tiranë, është nxitur bashkëpunimi mes fermerëve, akademisë dhe sektorit privat për të mbështetur zhvillimin rajonal dhe të qëndrueshëm. Kjo qasje ka fuqizuar komunitetet rurale, ka forcuar politikën bujqësore dhe ka përmirësuar mundësitë për agroturizëm dhe eksport.

Një platformë dixhitale është në zhvillim për të mbështetur SME-të në proceset e tyre të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, gjurmueshmërisë dhe promovimit të produkteve të BAM. Platforma do të ndihmojë në adresimin e sfidave të tregut dhe në promovimin e produkteve shqiptare në tregjet globale.

Një Rrugëtim Drejt Një Sektori Modern dhe të Qëndrueshëm

GQSP ka krijuar një model suksesi për përshtatjen e standardeve me kërkesat evropiane dhe për ndihmën e Shqipërisë në përmirësimin e kapitujve të BE-së. Ky program ka bërë që fermerët dhe SME-të shqiptare jo vetëm të përshtaten me standardet, por edhe të fillojnë të rriten dhe të zhvillohen në një treg gjithnjë e më konkurrues.

Ndërsa Shqipëria vijon rrugëtimin e saj drejt integrimit evropian, angazhimi i institucioneve, fermerëve dhe SME-ve mbetet jetik për të konsoliduar këto përparime dhe për të siguruar një sektor bujqësor që plotëson kërkesat e tregjeve globale. Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes institucioneve publike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë si UNIDO është çelësi për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme dhe të begatë për agrobizneset shqiptare.

Integrimi në BE është më shumë sesa përafrimi i rregullore, është një mundësi për të transformuar sektorin bujqësor në një model suksesi që jo vetëm përbush standardet ndërkombëtare, por edhe forcon jetesën e komuniteteve rurale. Me një angazhim të përbashkët dhe një vizion të qartë, Shqipëria mund të vendoset si një furnizues i respektuar i produkteve cilësore dhe të qëndrueshme në tregjet evropiane dhe globale.

INFORMACIONE

“Tregu i gjelbër” në Berat, Demo: Hapësirë dinjitoze në shërbim të 120 tregtarëve

Në Berat së shpejti 120 fermerë dhe tregtarë do të kenë hapësirën e tyre dinjitoze për të treguar mallrat e produktet.

Kryetari i bashkisë së Beratit, Ervin Demo tha sot se aktualisht punimet për “Tregun e gjelbër” janë në fazën e vendosjes së tendave, me të cilat përfundon investimi i plotë.

“Ky investim do t’i japë zgjidhje problemit të organizimit të tregut ditor në zonën urbane. Tregu do u shërbejë fermerëve dhe tregtarëve për shitjen e produkteve bujqësore dhe fruta-perimeve me shumicë dhe pakicë”, theksoi Demo.

Sipas tij, tendat janë projektuar duke iu përshtatur peiza-

zhit dhe do të krijojnë kushtet e favorshme për të patur një treg jonin 1, do të ketë parkim dhe ndriçim. Projekti financohet



atraktiv edhe për vizitorët. Tregu, i pozicionuar në Rana nga AZHBR me bashkëfinancim të bashkisë Berat.

Vlorë, vijon puna për kalimin e tokës bujqësore nga përdorim, në pronësi

Agjencia Shtetërore e Kadastrës në Vlorë është në proces

Specialistët janë të angazhuar që të bëjnë kontrollin e

terren për të përcaktuar me saktësi pozicionin dhe sipërfaqen e parcelave; Afishimin publik të listave dhe trajtimin e çdo pretendimi apo ankese të qytetarëve.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës është në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, prefekturat dhe këshillat bashkiakë për të siguruar finalizimin e këtij procesi.

Pasi kryhet verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit, dosjet përfundimtare delegohen për miratim pranë këshillave bashkiakë dhe prefektit.

Në përfundim të procedurës administrative, përfutuesit pajisen me aktin individual të kalamit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore.



pune në blloqet në hyrje të këtij qyteti, për kalimin e tokës bujqësore nga përdorim, në pronësi.

detajuar të dokumentacionit referuar përcaktimeve në kuadrin ligjor: Verifikimet në

Shpallen fituesit e fondeve në bujqësi - Nafta dhe 7 masat, 70 mijë fermerë përfitues

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka shpallur listën përfundimtare të fermerëve që do të përfitojnë fonde në bujqësi.

Referuar listës janë në total 14.776 fermerë që do të marrin para, nga 15.591 aplikime që kishin kaluar fazën e parë të përzgjedhjes për 7 masat e Skemës Kombëtare, apo rreth 85 për qind e aplikantëve totalë, duke përjashtuar mbështetjen me naftë për punime të mekanizuara në bujqësi.

Konkretisht numri më i lartë i fermerëve të kualifikuar i përket mbështetjes për blegtorinë, për tufën bazë të matriculuar, të imta dhe gjedhin me mbi 9 mijë fermerë.

Bletaria po ashtu ka pasur interes shumë të lartë ku janë kualifikuar 4318 aplikime. Ndërkohë, si një masë e futur për herë të parë, duket se interes të shtuar ka pasur edhe për bimët mjekësore, si dhe masa e mbështetjes për serat. Për masën mbështetje për fermat

organike janë kualifikuar 169 aplikantë dhe për certifikimin global GAP 48 aplikantë.

Referuar të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, këtë vit Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi regjistroi një numër total prej 71.537 aplikimesh, nga të cilat 54.255 ishin për mbështetje me naftë dhe 17.282 fermerë interesuar për të përfituar nga masat e mbështetjes, ku 21 prej tyre ishin Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor dhe 1685 grupime fermerësh.

Sa i takon skemës së naftës në bujqësi, për vitin 2024

rezultun se përfitues në total janë 52.183 fermerë, të cilët do marrin para cash për të mbuluar shpenzimet për këtë qëllim.

Të dhënat e detajuara tregojnë se qarku Fier, ku dhe bujqësia është më e zhvilluar, është ai që kryeson për nga numri i aplikantëve dhe përfituesve, ndjekur nga Qarku i Korçës, Beratit, Shkodrës, Elbasanit dhe Vlorës.

Nga fondet në bujqësi sivjet janë në total rreth 70 mijë përfitues apo 77% të gjithë fermerëve të regjistruar në vend. Fondi fillestar i vënë në dispozicion është 32 milionë euro.



Sfungjeri bimor i prodhuar në Berat fiton terren në tregun europian

Sfungjeri bimor i prodhuar në fushat e Beratit është produkti më i ri që po fiton terren në tregun europian nën markën “Made in Albania”.


Kultivimi i sfungjerit natyral, i cili zëvendëson sfungjerin sintetik, është bërë i mundur falë iniciativës së inxhinierit Rakip Belishaku nga Kuçi i Beratit.

Kryeministri Edi Rama solli në vëmendje këtë sipërmarrje të re, ndërsa shprehu respektin për njerëzit e punës si inxhinieri Rakip Belishaku, i cili është rikthyer në fshatin e tij të lindjes dhe ka investuar në kultivimin e sfungjerit natyral, një produkt ekologjik që zëvendëson sfungjerët sintetikë.

“Ky produkt që po tregohet nën markën “Rinora”, falë edhe bashkëpunimit me një kompani gjermane, po fiton

terren edhe në tregun europian nën etiketën “Made in Albania”, u shpreh Rama.

Sfungjeri bimor prodhohet nga bima e luffa-s, e cila origjinën e ka nga Azia. E ngjashme



Sfungjeri bimor po prodhohet në Shqipëri nga një bimë e rrallë aziatike dhe konsiderohet një produkt miqësor me mjedisin dhe natyrën.

me kungullin, kur fruti i saj është i njomë mund të konsumohet për gatim, ndërsa kur thahet krijon një fibër, e cila shërben si sfungjer natyral.

Dita e Tokës - Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe UBT leksion të hapur për nxënësit e “Emin Duraku”

Në kuadër të Ditës Botërore të Tokës, Intesa Sanpaolo Bank Albania, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, organizuan një leksion të


të ndërgjegjësive brezat e rinj për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së planetit tonë. Përfaqësues të Bankës dhe UBT-së ndanë me nxë-

u fokusuar në tema si: ulja e ndotjes, riciklimi, dhe ruajtja e burimeve natyrore.

Nxënësit patën mundësinë të mësojnë për rëndësinë e sjelljeve të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe për rolin e tyre në ndërtimin e një të ardhme më të qëndrueshme. Përmes diskutimeve dhe materialeve edukuese, ata u inkurajuan të bëhen ambasadorë të ndryshimit pozitiv në komunitetet e tyre.

Ky aktivitet është një shembull i përkushtimit të Intesa Sanpaolo Bank Albania për të promovuar praktikën mjedisore dhe për të investuar në edukimin dhe ndërgjegjësimin e brezave të rinj.

Të gjithë kemi një rol për të luajtur për një planet më të pastër dhe më të gjelbër!



hapur për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Emin Duraku”

Ky aktivitet kishte si synim

nësisit informacione të vlefshme mbi praktikën më të mirë për ruajtjen e mjedisit, duke

Dita e tokës mëmë - Promovohen prodhimet bio, rreziku i zhdukjes së varieteteve bimore

Ushqimet e shëndetshme, si komponenti kryesor i një organizmi të shëndetshëm, gjithnjë e më shumë rrezikojnë të zhduken të sfiduara fort nga ushqimet e shpejta.

Në Ditën e Tokës Mëme, fermerët e zonës fushore të Elbasanit janë mbledhur në një takim që synon promovimin e prodhimeve bio dhe rëndësinë e tyre.

Tashmë është shumë e rrallë që një ushqim të gjendet tërësisht natyral ndërsa OKB vlerëson se 75% e varieteteve bimore të ngrënë kanë humbur në mënyrë të parikthyeshme.

Përpos kësaj, gatimet tradi-



cionale bëjnë pjesë në identitetin e një krahine apo zone

të caktuar, identiteti i cili gjithashtu po zhduket.

Festat e fundvitit, AKU kontrolle të shtuara për sigurinë ushqimore

Drejtori rajonal i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Shkodër, Ramir Hadëri bëri të ditur se bazuar në planin e masave të ndërmara për festat e fundvitit, gjatë gjithë muajit dhjetor do të monitorohen dhe inspektohen rreth 450 subjekte në të gjithë qarkun.

“Në fokus të këtyre inspeksioneve do të jenë të gjithë operatorët e biznesit ushqimor me risk të lartë, si stabilimentet, subjektet që prodhojnë dhe përpunojnë produkte ushqimore, restorantet dhe marketet, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore në këtë prag festash fundviti”, tha ai.

Sipas tij, AKU do të jetë pjesë e kontrolleve edhe në tregjet e hapura dhe ambulante.

“Kontrollet do të kryhen mbi bazën e një marrëveshje-

je institucionale. Për ne fusha e kontrollit janë vetëm subjektet që disponojnë nipt, por kjo nuk do të thotë që në kushtet

u shpreh ai.

AKU apelon qytetarët të denoncojnë çdo rast të konstatuar jashtë kushteve higjien-



e flagrancës mund të ushtrohet një aktivitet i paligjshëm në fushën e ushqimit dhe të ketë tolerancë nga ana jonë”,

no-sanitare, apo tregtim jashtë datës së skadencës, duke ndihmuar kështu në garantimin e sigurisë ushqimore.

Gjirokastra destinacion i kërkuar për festat. Qyteti i gurtë i preferuar sidomos nga vizitorët e huaj

Prag festat e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri 2025 në Gjirokastrë kanë krijuar një atmosferë të veçantë. Komplekset muzeale, ndërtesat

karakteristike dhe rrugët e kalldrëmta janë zbuluar nga dekorimi dhe dritat shumëngjyrëshe duke e bërë qytetin e gurtë tërheqës për

turistët edhe në stinën e dimrit.

“Ka disa vjet që në Gjirokastrë në festat e fundvitit ka pasur dhe ka vizitor”, u shpreh Maksim Hoxhas, Kryetar i Dhomës së Tregtisë, Gjirokastrë.

Në nisje të muajit dhjetor konstatohet një interes në rritje i turistëve, kryesisht të huaj për të vizituar Gjirokastrën. Bizneset hoteliere dhe strukturat akomoduese kanë rritur prenotimet për ditët e festave të fundvitit.

Përgjatë këtij viti Gjirokastra është vizituar nga rreth 600 mijë turistë, pjesa më e madhe e të cilëve janë turistë të huaj.



Një artizane e përkushtuar, punimet e artizanet të preferuara në çdo stinë

Dhurata Shiroka, një artizane e përkushtuar prej 20 viteve e cila krijon dhe stilon veshje të ndryshme tradicionale. Sapo hyn në ambientin e saj të punës janë pikërisht këto motive popullore të endura me mjeshtëri nga duart e saj që bien në sy dhe bën që të ndalosh për një moment dhe ti sodisësh ato.

Të jesh artizane nuk është fort e lehtë sepse duhen orë të tëra të realizosh një veshje tradicionale, e për më tepër veshja qytetare e Shkodrës e cila kërkon kohë dhe mund për ta realizuar me çdo detaj që ajo mbarat mbi vete.

Veshjet tradicionale të punuara nga artizania Dhurata Shiroka janë të preferuara

në çdo kohë dhe në çdo stinë të vitit, madje dhe turistët e huaj tregojnë interes dhe duan të marrin një kujtim me vete qoftë një motiv apo një simbol kombëtar nga Shqipëria.

Dhurata nuk do t'ia dijë për vështirësitë që ka gjatë punës por vazhdon të punojë me pasion si një artizane e përkushtuar në qytetin e Shkodrës.



Rama: Shkolla e Hoteleri-Turizmit me standardet e Lozanës, mundësi e shkëlqyer për gjeneratën e re të profesionistëve

Kryeministri Edi Rama së bashku me ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja dhe ambasadorën e Zvicrës në Tiranë, Ruth Huber ishin në shkollën e Hoteleri-Turizmit në Tiranë, e cila

Lozanë që janë standardet me cilësi shumë të lartë. Një përfaqësim i standardeve më të larta të Zvicrës. Pra mendoj që është një mundësi e shkëlqyer për ju dhe të keni një të ardhme të shkëlqyer këtu në vend ku ka një

sepse unë nuk e kam menduar personalisht që në një kohë kaq të shkurtër ne do të arrinim të përmbushnim të gjitha standardet e kërkuara nga shkolla e Lozanës, sepse këta janë zvicëranë dhe ju e dini shumë mirë si është ajo shprehja popullore “kërkojnë qimen në vezë”, por këta në fakt kërkojnë qimen në qime. Dhe fakti që pas kanë kërkuar qimen në qime janë plotësisht të angazhuar dhe tani kemi këtë binjakëzim, që nuk është binjakëzim simbolik, por është një binjakëzim i punës i përditshme, kjo është një gjë fantastike për të gjithë ata që studiojnë dhe që do të studiojnë në këtë shkollë, sepse kur të dalin do të kenë një dokument që provon që kanë marrë okejin nga shkolla e Lozanës për të shërbyer në Hoteleri-Turizëm dhe patjetër pastaj me atë dokument do të shkoni dhe do të kërkonin paga shumë të larta”, tha Rama.

Zv/ministrja e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Olta Manjani u shpreh se, ambientet e shkollës janë ambiente të investuara në kuadër të projektit të binjakëzimit dhe se është bërë një punë dyvjeçare, që nga momenti që ka ardhur EHL-ja me gjithë grupin e vetë të konsulencës, bënë një analizë fizibiliteti, bënë një studim dhe vizita me të gjithë aktorët e turizmit në vend.



tanime është nën ombrellën e EHL, shkollës së famshme të Hotelerisë së Lozanës në Zvicër, e njohur si më e mira në botë për profilet e industrisë hoteliere, e cila tanimë do të përgatisë gjeneratën e re të profesionistëve të biznesit të mikpritjes, për Shqipërinë 2030.

Ambasadorja Huber iu drejtua studentëve se studimi i në këtë shkollë është një mundësi e shkëlqyer.

“Kjo shkollë, siç kam pasur mundësi të shoh është shumë mirë e pajisur dhe shohim që ekipi është shumë i motivuar, drejtorët dhe mësuesit. Tani të ngritur të standardet të hotelerisë në

kërkesë të madhe për njerëz të kualifikuar mirë në sektorin e mikpritjes dhe turizmit”, tha Huber.

Kryeministri Edi Rama e cilësoi si historike për gjithë sistemin e edukimit dhe të trajnimeve profesionale.

“Është realisht historike kjo për gjithë sistemin e edukimit edhe të trajnimeve profesionale, sepse tanimë këtu vihet në shkollën e mesme të Hoteleri-Turizmit, por studiohet me standardet dhe me të gjithë diturinë e shkollës së Lozanës EHL, që është në mos shkolla më e mirë në botë, një nga 3 shkollat më të mira në botë. Dhe për ne është vërtetë një moment krenarie,

"Fshatrat, në rritje me agroturizmin si alternativë" - Sokol Duma: Të rrisim investimet në alpe pa prekur zonat e mbrojtura

Paketa e maleve po ngjall interes, sidomos ndër indi-

Institucionin për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

zonat e mbrojtura të vendit.

Nga ana tjetër, në këtë panel ishte i ftuar edhe zëvendësministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Sokol Duma.

Ai foli me entuziazëm rreth paketës së maleve, duke theksuar se ky projekt ofron mundësi të shkëlqyera për emigrantët shqiptarë që jetojnë në diasporë, duke u dhënë atyre mundësinë të investojnë në tokat e paraardhësve të tyre.

Paketa e Maleve vjen si një iniciativë nga qeveria për të kthyer fshatrat e boshatisur nga emigrantët të larguar në diasporë, në një vend ku mund të zhvillohet agroturizmi, apo aktivitete të tjera për këta individë që kanë braktisur zonat rurale.



vidët që e shohin këtë iniciativë si një mundësi të re për zhvillim. Ky interes kulmoi në një dëgjuesë publike, të organizuar në bashkëpunim me

Mesazhi kryesor i kësaj ngjarjeje ishte që ky projektligj, i cili ka rëndësi të madhe për zhvillimin e zonave të vrashda malore, pa cënuar cënuar

“Bimët dhe Shqiptarët” - Një prurje shkencore autentike

Rreth librit të Prof. Dr. Lufter Xhuveli “Bimët dhe shqiptarët” (nga neoliti në shekullin 21-të), si një dëshmi kërkimore brilante që hedh dritë mbi rrënjët e vërteta të kombit tonë



Shefqet Meko, Minneapolis, 30 Nëntor 2024

Prej kohësh, libri “Bimët dhe shqiptarët”, me dedikim nga autori, është “përgjumur” në bibliotekën time në Minneapolis. E kam shfletuar herë pas herë dhe jam përpjekur të përtyp prurjet shkencore, analizat, gjykimet dhe konkluzionet që të befasojnë.

Nuk është as roman, as poezi, që të lexohet “duke pirë kafe” edhe pse autori mrekullisht ka mundur të sjellë një mozaik të rallë shqiptar, duke na përshkruar edhe frymëzime poetike, mençuri popullore që do ishin mbase të pamundura pa frymëzimin e natyrës “qëndisur” nga bimët.

Në të vërtetë edhe kur e merr në duar është një “libër i rëndë” që vërtet ia ndjen njëherazi peshën e mendimit. Është i tillë, sepse për aq sa gjatë dhe i mundimshëm i autorit, një “eksperiment” i klorofilit, një lloj shpërthimi kërkues, ku përzihet lashtësia, historia dhe e vërteta rrekur nga stuhia e pandalshme e viteve, për të sjellë para lexuesit një “dëshmi shkencore” duke vërtetuar me

prova, fakte, gjeneza shkencore e biologjike se kemi qenë këtu “ka her e mot”. Libri në fjalë është një vlerë e spikatur në mendimin shkencor bujqësor shqiptar. Duke lexuar prurjet e autorit, të vjen si një fepjse magjike puna e mundimshme, me sa duket e përditshme dhe e vijueshme, duke shënua hap cilësor në kërkimet e kësaj fushe, që meriton vëmendje dhe debat. Që në fillim autori ka bërë kujdes që të mbështetet mbi burime, prova dhe fakte përtej vetes, duke sjellë 357 burime bibliografike dhe duke u konsultuar me arkeologe, biologë, gjuhëtarë, entografë e specialistë të tjerë, çka i jep librit një seriozitet dhe përgjegjshmëri të spikatur. Në këtë kuptim “Bimët dhe shqiptarët” të duket si një kolegjalitet shkencor, një gjithëpërfshirje intelektuale tejet domethënëse duke e bërë autorin krenar dhe miqtë e kolegët e tij po aq të gëzuar.

Nuk ka shumë studime të kësaj natyre që të përballë një komb dhe etni të caktuar me bimët, që mund të themi janë një “parzmorë” natyrore, që ka mbrojtur kombet nga zhdukja dhe zhbërja duke garantuar edhe vijueshmëri dhe pavarësinë e jetës së Njeriut si kryekupola e Botës së Gjallë. Prof. Dr. Lufter Xhuveli në këtë libër-studim na zhyt thellë nga koha e neolitit, siç shënohet në titull, deri në ditët që jetojmë duke provuar se lashtësia shqiptare në trojet e veta, konfirmohet jo vetëm nga historia, arkeologjia, statujat dhe legjendat, por edhe nga farërat e bimët shqiptare, që jo vetëm nuk janë zhdukur, por mrekullisht kanë evoluar së bashku edhe me profilin e kombit tonë. Simbioza historike Bimë-Shqiptarë, është kredoja e këtij libri me vlera të veçanta. Të fut në mendime fakti që mbase shumë nuk e dinë, që autori e nënvizon që në parathënie se në nderim të Kongresit të Manastirit, Sotir Çurçia nga Shkodra, dhuratën më të bukur e ka bërë me një poemth ku për “çdo gërmë e alfabetit kishte një strofë dhe çdo strofë e këngës i kushtohej një luleje të veçantë”. Kjo në të vërtetë dëshmon atë ngjizje të llavtë, mes njeriut dhe natyrës si një ndërverim universal në gjithë procesin evolues. Për më tepër, rasti dëshmon marrëdhëniet virale mes shqipes dhe “vargonjeve”

të saj me bimësinë dhe vetë natyrën e mrekullueshme shqiptare. Një fakt i tillë ndërkohë zhbën tërë atë paragjykim të tipit racist shqiptar ndaj njerëzve të bujqësisë të cilët zbukurojnë vendin dhe mbushin tregun duke dremitur me libra në duar. Ky shpirt i papeur qëndrestar, në fakt është edhe “kollona vertabrle” e kombit që në kohë të vështira me “një koqe misër” ka mposhtur urinë duke siguruar pavarësinë e vet në paqe me bimët dhe natyrën.

Në 351 faqet e këtij libri-studim, ilustruar me 101 fotografi, harta dhe piktura, 22 tabela faktesh dhe 68 shënime të posaçme, gjen historinë e botës dhe veçanësitë shqiptare, pikëvështrimin e shkencëtarëve të shquar nga Bota, që kanë gërmuar suksesshëm në këtë fushë dhe pikvështrimet e posaçme të Prof. Xhuvelit që ngërthehen bukur në këtë në çdo kapitull dhe analizë. Në nënkaptullin “Lindja e bujqësisë”, të ngel në mendje “fshati i parë bujqësor në botë”, siç shënon autori Jericho, në Lindjen e Afërme, që me rreth “300 banorë... i shtrirë në një sipërfaqe prej 2.5 ha” u bë edhe “ADN”ja historike e zhvillimit bujqësor, i cili në ditët e sot-

shpjegohet shkëncërisht domestikimi në Shqipëri i shegës, ullirit, dardhës, hardhisë etj. etj.


Me këtë botim, Prof. Lufter Xhuveli, dëshmon me prova pa sionin e vet kërkues, hulumtues, kulturën erudite dhe vëmendjen e posaçme ndaj bujqësisë dhe veçmas, për trashëgiminë gjenetike bimore. “Kam punuar si kalë” ka qejf ta përsëritë autori në bisedë të lirë, si simbolikë jo thjesht të talentit të tij si njeri i kërkimeve bujqësore, por edhe si një agronom i kohëlexuar në mënyrën më të gjërë. Botimi në fjalë rrëfen një “Lufter tjetër” një njeri “pa kostumin politik”, që di të gërmojë, analizojë, të përballë fakte dhe dëshmi të kahershme, me gjakftohtësi dhe ekuilibër shkencëtar, duke i “vënë në rresht” me një qëllim sublim: Vërtetësi dhe realizëm shkencor. Libri “Shqiptarë dhe bimët” është si një testament shkencor i autorit, që për mendimin tim mund dhe duhet të futet në kurrikulumet e Fakultetit të Agronomisë, për prurjet dhe konkluzionet shkencore që “ballcamosin” autoktoninë shqiptare me prova dhe fakte të pakundërshtueshme. Libri, që është dëshmi e një punë këmbëngulëse në deka-

da, ndërsa e shfleton dhe mëson aq shumë për bimët, farërat dhe “misionin” e tyre për ta bërë jetën të pavarësisht mbi Tokë, ku njerëzit që i janë përkushtuar bujqësisë dhe kërkimit shkencor në këtë fushë, të kujtojnë një thënie të Ciceronit se “Nuk ka një profesion më të mirë, më të kënaqshëm, më të gëzueshëm dhe që të bën më të nderuar se sa bujqësia”...

Në 21 kapituj të strukturuar mjeshtërisht, Prof. Xhuveli i sjell mendimit bujqësor dhe arshivave akademike, një libër të artë në kuptimin qëndrueshmërisë ndaj kohës dhe “tallazeve” shkencore në të ardhmen. Kjo sepse në qendër të librit autori ka vënë veten, si një këmbëngulës i rrallë, me akumulime shkencore dhe kulturore, me përvoja dhe

eksperiencia të mëdha në fushën e bujqësisë dhe mendimit modern shkencor. Personalisht kujtoj kontributet personale të autorit pas viteve 90-të, veçmas në fushën krijimit të Bankës Gjenetike Shqiptare, kur përmes programeve të FAO-s, ka sjellë studjues dhe shkencëtarë të ndryshëm nga gjithë bota, ku dallohen ata gjermanë, gjë që konfirmon edhe atë zbulim të ekspeditave gjermane qysh në vitin 1941, ndërsa bota tronditej nga Lufta e Dytë Botërore. Ky dokumentim interesant në këtë libër dëshmon edhe një gjë tjetër: Në çdo krizë apo luftë që shkakton “njeriu i çmendur”, shkenca dhe shkencëtarët kërkojnë “dritën dhe paqen” për të nesërmen, duke mos rreshtur kërkimet dhe zbulimet e tyre që gjithsesi i shërbjnë zhvillimit dhe civilizimit modern. Mendoj se kjo është sa e bukur aq edhe emocionuese. Njeriu i paepur me emri Lufter Xhuveli, ka krijuar mjeshtërisht “arkivën” e vet shkencore si një thesar i pahumbshëm dhe i pakonvertueshëm me asnjë “monedhë” financiare. Ai sikur shëtit me mendim dhe vëmendje kërkimtari mes natyrës dhe farërave, mes të shkuarës dhe së tashmes duke synuar të mbetet në të ardhmen me egon e vet profesionale, si një “farë” e llojit të vet. “Fara, shkruan Xhuveli, është një organizëm i gjallë me veti prizmatike, e cila ngjizet, lind, rritet, zhvillohet, pëson ndryshime...piqet, merr frymë, fle, zgjohet, shpërthen, evoluon, përshtatet, ndryshon, sëmuret, shëndoshet, shumohet, emigron, përhapet dhe plaket...Fara, nënvizon autori, në rrugëtimin e saj si një spirale pafund, është njëherësh një fund dhe një fillim”.

Xhuveli “në pension”, nuk ka shterur punën e vet. Ai së fundmi ka sjellë për “vete dhe fisin” por edhe më gjerë librin “Rrënjë e degë” një vetërrëfim brilant intelektual dhe padyshim edhe i krenarishëm, si autor i lindur në Labëri, por që në të vërtetë “Bimët...” dhe “Rrënjët...” në mënyrë spontane dhe domethënëse zbulojnë të njëjtën gjë që nuk do të zhbëhet më dot kurrë: Kemi qenë këtu, në Ballkanin e lashtë dhe kemi moshën e tij, si komb i padiskutueshëm që Liria na dha shansin të “rigjejmë veten”.



me jo vetëm mirëushqen njerëzimin, por është edhe industria më e madhe e biznesit botëror që mban gjallë miliardat e njerëzimit, pa të cilin nuk do kishim shansin e qytetërimeve moderne. “Ritmi i përhapjes së Revolucionit Neolitik, shënon Prof. Xhuveli, është kushtëzuar nga mjedisi natyror dhe gjeografia e terrenit, mënyra e transportit (tokësor, ujqor) nga faktorët klimatikë dhe ata sociale”. Mënyra se si Xhuveli na sjell pikëvështrimet e kërkuesve të shquar botërorë në këtë fushë, të mbërthen në lexim e të bën të përfytyrosh zhvillimin e evoluimitin e shoqërisë njerëzore si një “tango e përjetshme” e Njeriut me Bimët, të cilat janë plazma e vërtetë e globit tonë dhe kanë “misione të posaçme” në mbajtjen gjallë të jetës biologjike dhe shoqërore.

Me interes të veçantë lexohet kreu mbi lindjen e bujqësisë në Shqipëri, që autori e sheh “me lupë” duke sjellë fakte që dalin nga shpellat, guvat dhe luginat deri në kalatë dhe kështejllat shqiptare, që evidentohen me kujdes duke datuar në mijëvjeçarë të largët. “Qytetërimi neolitik në shqipëri, shënohet në libër, ka lidhje me praninë e hershme të banorëve autoktonë, me pozicionin e saj gjeografik dhe kushtet e favorshme klimatike për rritjen e bimëve dhe kafshëve...Prova e përhapjes së agropastoralizmit në Shqipëri janë zbulimet arkeologjike, analizat morfologjike dhe botanike të farërave, mbeturinave bimore, kallinjve... , pjalmi, veglat e punës prej stralli etj.” Duke konkluduar që “kultivimi i bimëve dhe zhvillimi i bujqësisë në Shqipëri, e ka zanafillën e vet që në periudhën e neolitit të hershëm në mijëvjeçarin e shtatë p.e.s.” Me një skrupulozitet kërkimtari e si vëzhgues i kujdeshëm edhe i fenomeneve që “ka ngrirë” koha, autori provon me fakte idetë e veta duke sjellë për herë të parë fotografi të farërave të karbonizuara të pesë kulturave bujqësore të hershme, një ulli 3-mijë vjeçar, ilustrimin domethënës që 246 fshatra që mbajnë emra bimësh, gjë që vërtet të befason dhe plot fakte të tjera interesante që konsolidojnë synimet e autorit. Libri dokumenton 3300 lloj farërash me “pasaportë” shqiptare në 65 Banka gjenetike të botës ndërsa

Agroturizmi përtej kornizave

Agroturizmet e konsoliduar kanë kuptuar se ushqimi i mirë dhe fjetja nuk janë të mjaftueshme për të mbajtur pas vetes gjatë një turist dhe për të rritur ndikimin në ekonominë lokale. Kjo ka bërë që disa prej tyre të dalin përtej kornizave të një biznesi që mendon vetëm brenda mureve të tij. Disa po nxisin investime të tjera në zonë, duke tentuar një model origjinal me një shkallë më të gjerë, siç po ndodh me Fishtën, ku kapaciteti akomodues gati është 3-fishuar në pak kohë. Të tjerë po mundohen të krijojnë itinerare natyrore dhe historike, që përfshijnë të gjithë zonën, duke plotësuar ofertën turistike për të nxitur më shumë aktivitete e për rrjedhojë më shumë njerëz të angazhuar. Kjo vjen në kushtet kur të huajt janë të etur për jetën origjinale të Shqipërisë rurale dhe për kuzhinën autentike të saj, diçka që nuk arriti të mbajë më të njëjtin intensitet këtë vit shqiptarët e Kosovës dhe vendasit.



që janë kthyer në lokomotiva të vogla të ekonomive lokale ku ushtrorjnë aktivitetin. Por ky efekt bëhet gjithmonë e më i madh, falë interesit për Shqipërinë autentike rurale, jetën e fshatit dhe mikpritjen tradicionale që përkufizon secilin rajon.

Të huajt, të magjepsur nga kjo anë e Shqipërisë, janë të etur ta shohin atë në çdo dimension, duke nxitur kështu sipërmarrësit e këtyre agroturizmeve të dalin përtej kornizave standarde të egos personale të biznesit dhe duke ngritur modele më gjithëpërfshirëse me komunitetin.

Një rast i tillë është Fishta, ku kapaciteti akomodues në këtë fshat është trefishuar brenda një kohe të shkurtër, teksa një model i përfshirjes së komunitetit dhe rritjes së potencialit turistik të zonës është edhe ai që po ndodh në Gjepalaj në Shijak.

Të dy agroturizmet janë të konsoliduar dhe ofrojnë

dy modele sa të ngjashëm, aq edhe të ndryshëm duke ruajtur autentikën që ka secila zonë.

Në këtë rast, një rol të rëndësishëm, përveç mentalitetit të zhvillimit të biznesit, luan edhe pozicioni gjeografik, aksesit në infrastrukturë apo promovimi që vjen si nga mediat sociale, ashtu edhe nga vlerësimet gojë pas goje të turistëve. Por cilat janë hapat e radhës që po hedhin këto subjekte për të mbajtur pas vetes turistët në çdo stinë?

Fishta gati trefishon kapacitetin akomodues, duke mos humbur identitetin

Një agroturizëm që nisi vite më parë në Fishtë e bëri atë epiqendër të tureve ditore që vinin të organizuar për të drekuar, ashtu siç ishte i madh numri i atyre që shkonin individualisht apo me familje për ta vizituar.

U desh kohë e gjatë që “Mrizi i Zanave” të hapte bujtinën me të paktën 9 dhoma që shumicën e kohës janë të rezervuara të gjitha. Teksa interesi është në rritje përtej kapacitetit, Altin Prenga, sipërmarrës i këtij agroturizmi ka vendosur që të nxisë investimin në akomodim te banorët e tjerë të zonës. Falë bashkëpunimit që kanë me njëri-tjetrin, tashmë janë 23 dhoma në fshatin Fishtë, të cilat mund të rezervohen nga turistët.

“Aktualisht, kapaciteti i strukturës është 9 dhoma, por kërkesa është rritur vazhdimisht, duke na nxitur që të bashkëpunojmë me banorë të zonës për t’ju përgjigjur kësaj kërkesë, por edhe për ta shtrirë ndikimin ekonomik të prurjes turistike.

Sot janë disa familje që kanë përshtatur banesat e tyre apo kanë investuar në drejtim të mikpritjes së turistëve, duke e çuar kapacitetin në 23 dhoma në Fishtë. Janë të lidhur me ne dhe kur ne jemi të rezervuar, kërkesat i adresojmë në secilën prej këtyre bujtinave”, – shprehet z. Prenga.

Shqipërisë, por duket se kjo do të ishte rrënim i identitetit të zonës. Në afatgjatë, sipas tij, kjo do të sillte më shumë dëm sesa të mira.

“Ne e nisëm këtë bashkëpunim me banorët e zonës për të rritur kapacitetet akomoduese, duke nxitur investimet e familjeve sepse ishte e pamundur që në Fishtë të bënim një hotel me 30-40 dhoma. Kjo do ta denatyronte originalitetin që ka sot kjo zonë. Do të ishte një dëm ekonomik.

Ne e kuptojmë që me llogari, mungesa e një hoteli të tillë është fitim i munguar, por do të kishim prishur një të ardhme dhe ky është një mesazh i mirë për t’u dhënë në këtë kohë. Investimet e gabuara janë e keqja e vetes”, shprehet z. Prenga.

Agroturizmet, itinerare të reja dhe ofertë të pasuruar turistike të zonës

Agroturizmet kanë kuptuar se mbajtja pas vetes në një mënyrë më afatgjatë e turizmit kërkon zhvillim të ofertës së tyre përtej strukturës dhe restorantit që ata ofrojnë.

sifikuar ofertën, duke ndër-tuar itinerare të rinj dhe pika panoramike të rajonit.

“Të huajt kanë shumë kuriozitet për fshatin. Ne jemi munduar nga viti në vit të shtojmë e pasurojmë ofertën tonë në agroturizëm si për sa u përket produkteve që ofrojmë, edhe investimeve funksionale të tij, por vetëm kaq nuk mjafton për të mbajtur gjatë një vizitor.

Ndaj jam angazhuar për të krijuar një itinerar me anët më të mira të zonës së Shijakut ku ndodhemi ne. Pra po kërkojmë seriozisht për pikat më të mira historike, ato pamjet më të mira panoramike të kodrinave dhe natyrës dhe të gjithçkaje që na rrethon.

Duam të sjellim më afër tek turistët historinë rurale që është pjesa më interesante e jona”, – shprehet z. Gjepali. Pika më e fortë e Shqipërisë, sipas tij, është jeta e fshatit dhe ofrimi i një eksperience të plotë të saj për të parë nga afër si ushqehemi, si jetojmë, cilat janë traditat dhe zakonet tona që në sytë e të huajve është diçka tërësisht origjinale.

Efekt i Kosovës ndihet edhe tek agroturizmi, problem edhe Euro

Lëkundja e turizmit që u vu re në sezonin veror me një prani më të ulët të shqiptarëve të Kosovës, por edhe vendasve, duket se është shfaqur edhe tek agroturizmet, por disi më e moderuar.

“Nëse flasim për shqiptarët vihet re një trend në rënie që u konstatua kryesisht gjatë qershorit me Kosovën. Për herë të parë në historinë tonë si agroturizëm kemi pasur një regres me 5% gjatë qershorit.

Kjo lidhet me faktin që mungonin vendasit dhe shqiptarët e Kosovës. Presim që kjo të rikuperohet gjatë dimrit dhe të ketë një kthim të tyre që nuk besoj se do të jetë i madh, por gjithsesi do të jenë të pranishëm”, nënvizon z. Prenga.

Për vendasit, shifrat më të ulëta argumentohen me faktin që përveç emigracionit, ndikim ka dhënë edhe tendenca e atyre që jetojnë këtu që gjatë pushimeve të kërkojnë alternativa të tjera jashtë vendit, falë edhe mundësive më të lira që ofrohen sot me fluturimet. Të njëjtin tendencë vëren edhe Fundim Gjepali.

“Për hir të së vërtetës, turistët nga Kosova kanë qenë të pakët në numër dhe kjo pritej pas liberalizimit të vizave. Ata ishin të detyruar në një lloj forme të vinin tek ne, sepse nuk kishin alternativa të tjera. Tani do të udhëtojnë në destinacione të reja dhe kjo nuk do të thotë se na kanë braktisur, por është një proces që vjen natyrshëm”, shprehet ai.

Zhvlerësimi i euro-s është një tjetër element që sado periferik në një pjesë të agroturizmeve sërish ka dhënë efektet negative.

Në disa raste i ka bërë paketat disi më të shtrenjta si në menutë e ushqimit ashtu edhe në rezervimet nëpërmjet platformave si Booking diçka që për turistët në shumë raste krijon përshtypjen se biznesi po mundohet të përfitojë.

Agroturizmet besnikë të kuzhinës me identitet, por edhe pak rifreskim

Kuzhina që ofrohet në agroturizme dominohet kryesisht nga tradicionajla, si elementi më domethënës dhe më i suksesshëm i tyre. Recetat janë ato origjinale të zonës, por duke i dhënë edhe një prekje nga shefat e kuzhinës që i bën edhe më të veçanta.

“Të huajt janë të uritur për produkte autentike. Ajo që servir është kuzhina e shtëpisë dhe e gjyshes, pra siç hamë ne në zonën e Shijakut me pjatat më të njohura, nga tava e dheut te byreku me qumësht, pula me qull apo bakllavaja.


Unë po mundohem gjithmonë të rishkruaj recetat e vjetra, duke i përshtatur me qiellzën e klientit” shprehet mastershef Fundim Gjepali.

Të njëjtin mendim duket se ndan edhe mastershef Altin Prenga, duke nënvizuar se një pjesë e mirë e shijeve që të huajt provojnë këtu janë të harruara prej tyre, si pjesë e bujqësisë intensive që ofrohet në vendet me popullsi të madhe.

“Ne jemi gjithmonë në kërkim të gjërave të reja, por jemi shumë pro ndaj asaj çfarë kemi aktualisht. Ne jemi me idenë që duhet pasur rrënjë dhe identitet, por edhe pak inovacion në atë që ofrohet. Janë elemente të vogla, duke përdorur ato që kemi, por gjithmonë duke mbajtur bazën dhe themelet e një kuzhine me identitet.

Për ta, çdo gjë që ju shkon në tavolinë janë të gjitha shije të harruara. Janë me shije autentike dhe të prodhuara nga fermerët të vegjël.

Sot vendet me popullsi të madhe ushqehen nga bujqësia intensive dhe kur shohin produkte ndoshta jo perfekte, por me identitet, japin përshtypje shumë të mira. E kanë shumë të vështirë të gjejnë diçka të tillë në vendet e tyre”, shprehet z. Prenga



Në një mundësi egoiste ndoshta këtë kapacitet mund të kishte zgjedhur ta ndërtonte i vetëm në një hotel, duke pasur parasysh interesin turistik që ka për jetën rurale të

Fundim Gjepali, nga agroturizëm “Gjepali”, shprehet se duke vënë re këtë tendencë të turizmit, ai po investohet seriozisht me historianë dhe banorë të zonës për të diver-



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

POLITIKA ZHVILLIMI

Ohri në rrezik nga ndërtimet e paligjshme dhe urbanizimi, UNESCO kërkon mbrojtje urgjente nga Shqipëria e Maqedonia e Veriut për ruajtjen e thesarit natyror

UNESCO, për të tretën herë, paralajmëron se rajoni i Ohrit është në rrezik nga ndërtimet e paligjshme, nga urbanizimi dhe planifikimi i papërshtatshëm. Nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kërkojnë veprime urgjente për ruajtjen e këtij thesari natyror dhe kulturor, në mënyrë që të mos futet në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik

dhe Strugën, ndalimin urgjent të ndërtimeve në Kënetën e Studençishtës, si dhe zgjidhjen e problemit të ndërtimeve pa leje që dëmtojnë karakterin autentik të rajonit.

“Shteti, gjatë vitit të kaluar, jo vetëm që nuk zbatoi asnjë nga 15 rekomandimet e UNESCO-s, por, në katër prej tyre gjendja është akoma më e keqe”, thonë nga organizata qytetare “Front 21/42”, e cila prej dhjetë vjetësh monitoron gjendjen në rajonin e Ohrit.

Radio Evropa e Lirë kërkojnë përgjigje nga autoritetet lokale të Ohrit, por deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori koment lidhur me raportin e ri të UNESCO-s, si dhe për reagimet e organizatave qytetare në vend që kërkojnë zbatimin urgjent të rekomandimeve, përfshirë ndërtimet e shumta pa leje.

Bazuar në të dhënat nga Komuna e Ohrit, të cilat REL-i i mori më parë, nga 1 janari i 2020-ës deri në shtator të vitit 2024, inspektorët kanë evidentuar 120 ndërtime të paligjshme. Ndërsa, nga korriku i vitit 2006 e në vazhdim, komuna ka evidentuar 869 ndërtime të paligjshme.

Përndryshe, vetëm në terri-

torin e komunës së Ohrit janë dorëzuar 15.939 kërkesa për përcaktimin e statusit juridik të gjithsej 19.935 objekteve të ndërtuara pa leje, nga të cilat 416 ndodhen në zonën e bregut

në territorin e Kënetës së Studençishtës, në Ohër, për të cilën është në fuqi vendimi për mbrojtje të përkohshme.

“Rasti ynë i fundit ilustron shumë qartë shkatërrimin e

institucione përkatëse, por thotë se pavarësisht komunikimit gjashtëmujor me inspektorët shtetërorë dhe lokalë, nuk janë ndërmarrë masa efektive.

“Për shkak të mosveprimit



të Liqenit të Ohrit, dhe 2.347 në territorin e Parkut Kombëtar të Galiçicës, sipas një dokumenti nga Komuna e Ohrit.

Kërkesat janë dorëzuar pas miratimit të Ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje nga viti 2011, me të cilin lejohej që ndërtimet pa leje të realizuara para këtij viti (2011) të legalizoheshin.

Por, nga organizata “Front 21/42”, alarmojnë për raste të reja të ndërtimeve të paligjshme

vlerave për shkak të moszbatimit dhe shkeljes së ligjeve pikërisht nga institucionet, detyra themelore e të cilave është t’i zbatojnë ato. Trashëgimia e vetme natyrore dhe kulturore në vend po shkatërrohet nga korrupsioni dhe krimi i organizuar dhe është viktimë e mungesës së sundimit të ligjit”, thonë nga organizata “Front 21/42”.

Aktivistët për këtë rast kanë dorëzuar iniciativë për mbikëqyrje inspektive në disa

të tyre, brenda kënetës është zhvilluar një kompleks urban, gjë që ka shkaktuar degradim të mëtejshëm të kësaj pike kyçe për biodiversitetin e Liqenit të Ohrit”, thonë nga organizata.

Masa edhe nga Shqipëria

Përgjegjësia për Rajonin e Ohrit nuk bie vetëm mbi Maqedoninë e Veriut. Detyrime ka edhe Shqipëria pasi një pjesë

e Liqenit të Ohrit që gjendet në territorin shqiptar është nën mbrojtje që nga viti 2019.

Shqipëria, ndër të tjera, duhet të rishikojë Planin e përgjithshëm të Pogradecit, të parandalojë zhvillimin urban në bregdet, si dhe në zonën e ndjeshme të Drilonit.

“Është e nevojshme që të dyja vendet të hartojnë një vlerësim strategjik mjedisor që do të analizojë efektet kumulative të aktiviteteve zhvillimore”, thekson UNESCO, duke shtuar se dialogu ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë duhet të intensifikohet – nga niveli më i lartë institucional deri në atë operacional – për të siguruar një zbatim të suksesshëm të rekomandimeve.

Deri më 1 shkurt 2025, të dyja vendet janë të detyruara të paraqesin një raport të përbashkët për progresin dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e rajonit.

“Është urgjentisht i nevojshëm një mobilizim i gjerë për të ruajtur vlerën e jashtëzakonshme universale të rajonit të Ohrit. Vendosja në listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik mbetet një opsion nëse nuk merren masa e nevojshme”, paralajmëron UNESCO.

Ohri, një simbol i historisë së pasur dhe bukurisë natyrore, përballet me një sfidë që kërkon forca të bashkuara nga të dyja vendet dhe vendosmëri për të ruajtur trashëgiminë e tij për gjeneratat e ardhshme.

Zbatimi i rekomandimeve për kërcënimet ndaj Liqenit të Ohrit dhe Parkut Kombëtar të Galiçicës po shqyrtohet edhe nga Komiteti i Konventës së Bernës.

E ardhmja e turizmit në rajonin verior të Shqipërisë

Në Shqipëri, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përgatitur Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2024-2030, e cila po konsultohet me ekspertë të fushës dhe komunitetet lokale. Siç njofton korrespondenti i Zërit të Amerikës, Pëllumb Sulo, pjesë e kësaj strategjie është edhe rajoni verior i vendit me pasuri të shumta natyrore, i cili, sipas ekspertëve, kërkon më shumë vëmendje për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe në veçanti, monumenteve të kulturës që po dëmtohen

të turizmit të trashëgimisë komuniste e cila mbetet akoma e pa eksploruar, të nxjerrim më tepër përparësi nga turizmi i

me Valbonën, Thethin, Bogën, Razmën, Lëpushën dhe Vermoshin, është shndërruar në destinacion të rëndësishëm për

“Gjithmonë turizmi ushtron presion në territor, ndaj duhet të kihet shumë kujdes. Në fakt, ne kemi zhvillu ekonominë në

dhe dëmit që kemi bërë në peisazh”, thotë ajo.

Pavarësisht vlerave turistike, thotë ekspertja Shkreli, zona e Alpeve po vuan nga fenomeni i shpopullimit, i cili, nëse nuk ndalet, sipas ekspertëve, mund t’a dëmtojë shumë shpejt turizmin në këtë rajon me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit malor.

“Thethi dhe Valbona tashmë janë shndërruar në sipërmarrje të fuqishme, por ata nuk janë banorë të përhershëm. Këto vendbanime ju shërbejnë si mundësi për të zhvilluar ekonominë e tyre, sipërmarrjet e tyre. Banorët largohen gjatë periudhës së dimrit dhe vijnë të qëndrojnë në Shkodër ku kanë banesat e dyta. Kjo, sepse i’u mungojnë shërbimet në zonën malore, ku kanë ndërtuar sipërmarrjet e tyre”.

Për arkitektin Zef Çuni, asnjë strategji në fushën e turizmit nuk mund të ketë efekt nëse



miqve dhe familjarëve, sidomos emigrantët që vijnë të vizitojnë familjet dhe qëndrojnë për një kohë të gjatë dhe që janë pjesë e flukseve turistike”, thotë ajo.

Vitet e fundit zona e Alpeve,

turizmin, por ekspertja e planifikimit urban, Eltjana Shkreli, paralajmëron se ndërhyrjet e pa kujdesshme në këtë zonë, duke mos ruajtur trashëgiminë, mund të rrezikojnë të ardhmen e turizmit.

këto zona, por në anën tjetër kemi dëmtuar jashtëzakonisht shumë trashëgiminë kulturore. I referohem vendbanimeve malore, kemi ndërhy në territor pa kritere përsa i përket respektimit të materialeve, formave

nuk arrin të frenojë dëmtimin e pasurive kulturore, të cilat vazhdojnë të jenë të rrezikuara dhe të pambrojtura edhe në një qytet si ai i Shkodrës.

“Nuk mund të ketë turizëm kulturor kur nuk ka monumente të kulturës të restauruara, të cilat fatkeqësisht po bien nga dita në ditë, njëra pas tjetres. Jemi dëshmitarë që në Shkodër janë prishur objekte jashtëzakonisht me vlerë arkitektonike, monumente të kulturës, por edhe monumente historike, siç është shtëpia e Luigj Gurakuqit, Kafja e Madhe, shtëpia e Daut Boriçit, ajo e Hodo Sokolit, shtëpia e Pashko Vasës që po dëmtohet, shtëpia e shoqërisë “Bashkimi”, etj”, tregon ai.

Nevoja e restaurimit të këtyre objekteve, mbrojtja dhe kthimi i tyre në destinacione të vizitueshme për turistët vendas dhe të huaj, sipas arkitektit Çuni, duhet të jetë përparësi e çdo strategjie në fushën e turizmit.

Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030 synon që Shqipëria të shndërrohet në lider të turizmit në rajon. Ajo parashikon rritjen me 138% të netëqëndrimeve në 2030 si dhe rritjen me 4 herë të ardhurave në buxhetin e shtetit nga formalizimi i sektorit të turizmit.

Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030, e hedhur për konsultim publik nga Ministria e Turizmit, e ndan Shqipërinë në 6 rajone turistike, mes të cilave edhe rajoni verior i brendshëm.

Drejtuesja e departamentit të turizmit në Universitetin e Shkodrës, Bresena Kopliku, thotë se përmes kësaj synohet zhvillimi i këtij rajoni, që vazhdon të ketë ritme më të ulëta zhvillimi në krahasim me pjesën tjetër të Shqipërisë.

“Shkodra në këtë strategji rezulton e ndarë në dy zona kryesore, në zonën e bregdetit të Adriatikut dhe zonën e brendshme veriore. Zona e bregdetit të Adriatikut, e cila shfaqet me karakteristikat më tepër të një turizmi sezonal veror për turizmin e plazhit dhe të diellit, ndërsa zona e brendshme veriore e fokusuar kryesisht në pasuritë natyrore, në terrenin e larmishëm të Shqipërisë së Veriut, por edhe në aspektet e trashëgimisë kulturore”, tregon ajo.

Sipas profesoresh Koplikut është e nevojshme të përcaktohet qartë oferta turistike që rajoni verior i ofron turistëve dhe që ata nuk e gjejnë në zona të tjera.

“Mund të synojmë edhe aspekte të turizmit religjioz,

Dhomë ekonomike Shqipëri-Kosovë, firmoset marrëveshja

Kryetarja e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Ines Muçostepa u prit nga kreu i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit

Malaj në takim zyrtar, me qëllim përmbushjen e deklaratës së objektivave të përbashkëta për themelimin e Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri-Kosovë, me vullnetin për rritje të bashkëpunimit ekonomik dhe strat-

egjik ndërmjet dy vendeve.

Palët ranë dakord për të gjithë hapat e mëtejshëm për funksionalizimin e Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri-Kosovë.

Dhoma Ekonomike Bilaterale Shqipëri-Kosovë do t'i shërbejë interesave të biznesit Shqipëri-Kosovë dhe do t'i propozojë qeverive të vendeve tona shqetësimet e komunitetit të biznesit nga të dyja vendet, në përputhje me objektivat e deklaratës së përbashkët për themelimin e Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri-Kosovë, e nënshkruar në mbledhjen e dy qeverive, më 26.11.2018, në Pejë.

Ky është një hap i madh drejt thellimit të bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë dhe zbatimit të deklaratës së objektivave të përbashkëta për themelimin e Dhomës Ekonomike Bilaterale Shqipëri-Kosovë.



Çmimi i vajit të ullirit arrin rekord, shkon deri në 1100 lekë/litër, pritet të shkojë deri në 1500 lekë

Çmimi i shitjes së vajit të ullirit sivjet arrin në nivele rekord. Në fabrikat e përpunimit çmimi i shitjes së vajit të paambalazhuar, varion nga 700, 800 deri 1,100 lekë për litër. Vjet vaji i paambalazhuar u shit me çmim nga 700 deri 800 lekë për litër.

Krahasuar me vjet çmimi i shitjes është rritur 38%. Përpunuesit thonë se edhe çmimi i vajit të ambalazhuar pritet të rritet, të shkojë deri në 15 euro për litër.

Përpunuesit kryesorë pohojnë se sivjet shtrenjtimi i çmimit ka ardhur nga rritja e kostos së prodhimit për shkak

“Dyfishimi i tarifave të krahut të punës është faktori kryesor që sivjet shtrenjtoi së tepërmi koston e prodhimit të vajit të ullirit. Nëse vjet pagesat për vjelësit ishin 200 lekë për shkundjen e 1 kg ulliri, këtë vit vjelësit janë paguar 400 lekë, pasi është e pamundur të gesh punonjës. Tarifa e shkundjes së ullirit 400 lekë për kg është tepër e lartë.

Një tjetër faktor që ka ndikuar te shtrenjtimi i koston prodhuese është rënia drastike e rendimentit të prodhimit. Nëse vjet për kultura që rendimenti i prodhimit ishte nga 15 deri 17 litra vaj ulliri për 1 kg

Edhe Kastriot Çuadri një ndër grumbulluesit dhe përpunuesit kryesorë në Berat tha sivjet pavarësisht se prodhimi i ullinjve është më i lartë krahasuar me vjet, konstatohet se rendimenti i prodhimit është në rënie.

“Faktorët kryesorë që kanë ndikuar te rënia e rendimentit është thatësira e lartë e muajit gusht, e cila thau pemët dhe lagështira e lartë në muajin shtator që shkaktoi fryrje të frutit të ullirit”, thotë ai.

Në vitin 2022 kur sasia e prodhimit ishte e lartë, nga fermerët vaji i ullirit u shit nën koston e prodhimit me çmim 350 deri 400 lekë për litër.

Për 2022, rendimenti i prodhimit për rrënjë ulliri, sipas të dhënave të INSTAT ishte 17,2 kg. Krahasuar me 2021, rendimenti për rrënjë u shtua me 37%. Në 2022 shtim pati edhe te numri i rrënjëve të ullirit. Në raport me 2021, numri i rrënjëve të ullirit u rrit rreth 2%.

Ndërsa për 2023, mungesa e prodhimit dyfishoi çmimin e shitjes së vajit të ullirit krahasuar me 2022. Nga fermeri vaji i ullirit u tregtua me çmim 700 deri 800 lekë për litër. Shtrenjtimi i çmimit erdhi nga rënia e prodhimit 30 deri 70% krahasuar me vjet. Vjet pati edhe shtim të sasisë së vajit të ullirit që u eksportua, kryesisht në Itali.

Për 2023, rendimenti i prodhimit për rrënjë ulliri, sipas të dhënave të INSTAT ishte 12,4 kg. Krahasuar me 2022, rendimenti për rrënjë ra 30%. Në 2023 shtim pati edhe te numri i rrënjëve të ullirit. Në raport me 2022, numri i rrënjëve të ullirit u rrit rreth 1%.



të dyfishimit të pagesave për vjelësit e ullirit dhe nga ekstremitetet e motit, që sollën rënie të rendimentit.

Silvana Subashi e fabrikës së përpunimit “Subashi” thotë se ndonëse sasia e prodhimit të ullinjve është më e lartë se vjet, rendimenti i prodhimit për shkak të thatësirës është shumë i ulët. Sipas saj, përfshirë edhe dyfishimin e pagesave për vjelësit, këta janë faktorët kryesorë që çuan sivjet koston e prodhimit të vajit të ullirit deri në 940 lekë për litër dhe të shitjes 1,100 lekë për litër.

ullinj, sivjet ka arritur 10 deri 12 litra. Rënia e rendimentit është drastike.

Për shkak të këtyre faktorëve kryesorë, dukë përfshirë edhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe shërbimin e ullirit, kostoja e prodhimit të vajit të ullirit llogaritet 940 lekë për litër. Ndërsa çmimi i shitjes së vajit do të jetë 1,100 lekë për litër. Te shtrenjtimi i çmimit të shitjes, përveç heqjes së skemës së TVSH-së po ndikon edhe shtimi i sasisë së vajit të papërpunuar që grumbullohet nga grosistët italianë”, tha ajo.

BE i ofroi Shqipërisë mbi 500 milionë euro ndihmë financiare vetëm në 2021-2024

Bashkimi European është ofruesi më i madh i ndihmës fi-

Publikimi i përditësuar i fillimit të dhjetorit tregon se

gjithëpërfshirëse dhe gjinore si dhe rritjes së gjelbër të qëndrueshme në Shqipëri.

Brenda të njëjtës mbështetje Bashkimi European saktëson fondin prej 115 milionë euro për rehabilitimin, ndërtimin e shkollave dhe objekteve kulturore pas tërmetit të 2019-s. Ndërkohë Plani Ekonomik i Investimeve për Ballkanin Perëndimor identifikon 10 investime kryesore në transportin e qëndrueshëm, energjinë e pastër, mjedisin, klimën, të ardhmen dixhitale, kapitalin njerëzor dhe sektorin privat. Qëllimi ishte mbështetja e tranzicionit të gjelbër dixhital si dhe sjellja e rajonit më pranë tregut të përbashkët të BE-së.

Për projektet në Shqipëri, Bashkimi European sjell në vëmendje se që nga viti 2020 ka mobilizuar 1,4 miliardë euro, falë 600 milionë eurove grante po prej tij. Fondet mblihen përmes instrumenteve të tillë si korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Bilanci i këtyre shifrave po sipas BE-së është aktualisht ndërtimi së bashku i kapaciteteve të gjenerimit të energjisë së rinovueshme 713 MW, instalimi i 185 linjave hekurudhore të rehabilituara, shërbime të përmirësuar uji dhe kanalizimesh për mbi 975 mijë banorë etj.



nanciare për Shqipërinë. Ndërsa deklaroi këtë fakt, shërbimi i publikimeve të Unionit kujton se vetëm në vitet 2021-2024 Shqipëria ka përfituar mbi 500 milionë euro ndihmë financiare dhe teknike në kuadër të IPA III.

ndihma në formë granti i pakthyeshëm i takon Paketës së mbështetjes për energjinë dhe saktësisht 80 milionë euro. Mbi 30 milionë euro kanë qenë mbështetje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e ekonomisë qarkulluese,

Bujqësia dhe sfida përballë ndryshimeve të klimës

Buletini Mujor Klimatik i Institutit të Gjeoshkencave, në edicionin e muajit Shtator 2023, shkruan: Muaji shtator, si një tejzgjatje e stinës së verës në vitet e fundit, edhe këtë vit nuk bëri përjashtim. Temperaturat e larta vijuan

dhjetor 2023 shënoi në pjesën më të madhe të vendit mbarimin e periudhës së vegjetacionit, për shkak të uljes së temperaturave nën 10°C.

Pra, në mes të dhjetorit, më në fund erdhi vjeshta - thuhet në një koment të këtij

së planetit, por sfida më e madhe sot është përshtatja me këto kushte të reja. Në një cikël artikujsh po trajtojmë situatën në disa sektorë që ndikohen drejtpërdrejt nga ndryshimet e klimës. Në artikullin e mëposhtëm trajtohet sektori bujqësisë, si më i ndjeshmi dhe më i rrezikuar nga ndryshimet e klimës.

Shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike

Pse duhet të veprojmë tani? Ndryshimi i klimës është tashmë një realitet. Ndryshimet klimatike janë çështja përcaktuese e kohës sonë dhe ne jemi në një moment përcaktues. Nga ndryshimi i modeleve të motit që kërcënojnë prodhimin e ushqimit, tek rritja e nivelit të detit që rrisin rrezikun e përmbajtjeve katastrofike, ndikimet e ndryshimeve klimatike janë në shtrirje globale dhe në shkallë të paprecedentë. Aktivitetet e përditshme njerëzore maksimizojnë efektin serë, duke bërë që temperatura e planetit të rritet edhe më shumë. Ndryshimet klimatike destabilizojnë ekuilibrin e temperaturës së Tokës dhe kanë efekte të gjera mbi qeniet njerëzore dhe mjedisin.



të ishin të pranishme. Muaji shtator 2023 rezultoi muaji më i ngrohtë në shkallë globale, me një vlerë prej 16.38°C ose +0.93°C më të lartë se mesatarja e periudhës 1991-2020. Edicioni i muajit Tetor, thekson: Nga pikëpamja agrometeorologjike, muaji tetor 2023 ishte më shumë një vijimësi e muajit shtator. Në seksionin Agrometeorologji, Buletini i muajit dhjetor verën: Muaji

instituti.

Ndryshimet klimatike po e modifikojnë marrëdhënien e njeriut me natyrën. Shqipëria është në hartën e vendeve ku këto ndryshime janë të dukshme. Sistemi i reshjeve ka ndryshuar, vera është më e thatë, më e nxehtë dhe më e gjatë, ndërsa dimri më i butë. Ka një debat ende të pashteruar mbi shkaktarët e ndryshimit të klimës dhe ngrohjes

AGROTURIZËM

Lonely Planet: Në Shqipëri ndodhet parku i parë kombëtar në Europë kushtuar një lumi 'të egër'

Platforma e njohur e udhëtimit Lonely Planet, ka shkruar për shpalljen e lumit Vjosa si park kombëtar, duke vlerësuar punën e palodhur të ambientalistëve për të bindur autoritetet shqiptare

kanë mbetur vetëm 15 ekzemplarë), vidrën dhe shqiponjën egjiptiane.

Krijimi i parkut të ri përfaqëson një rezultat të madh për sektorin e turizmit shqiptar: vendi fiton prestigj dhe atraktivitet dhe udhëtarët e vëmendshëm ndaj çështjeve mjedisore kanë një destinacion të ri të përshtatur sipas dëshirave të tyre.

Për të zbuluar Vjosën, udhëtoni përgjatë autostradës SH4 nga qyteti jugor i Sarandës, në bregdetin Jon të Shqipërisë së Jugut, në qytetet e Tepelenës dhe Memaliajt, një rrugë që kalon nëpër peizazhe të mrekullueshme.

Vendet më të mira për të parë parkun e ri kombëtar të lumit Vjosa

Vjosa konsiderohet nga shumëkush si "lumi i fundit i egër në Europë", ku i egër do



të thotë pa argjinaura dhe diga përgjatë gjithë rrjedhës së tij.

Një nga mënyrat më të mira

për të vlerësuar plotësisht fuqinë e Vjosës është të bëni rafting në ujërat e saj. Lonely Planet

rekomandon të merrni pjesë në një turne aventure, që nisat nga qyteti i Përmetit; kohëzgjatja mund të ndryshojë nga dy orë

në disa ditë, në varësi të preferencave të pjesëmarrësve.

Atyre që nuk u pëlqejnë shumë aktivitetet, mund të eksplorojnë Përmetin, një nga vendet më të gjelbra dhe më të ruajtura në të gjithë vendin (i njohur si "Qyteti i Luleve"). Relaksohuni në banjat termale në Bënjë ose shijoni ushqimet dhe verërat e shijshme, që gjenden vetëm në këtë zonë të Shqipërisë.

Nëse doni të bëni një foto perfekte të Vjosës, shkoni në kthesën e lumit, që është gjysmë ore me makinë nga Përmeti. Me peizazhe përrallore malore, ky vend do t'ju lërë pa fjalë në çdo kohë të vitit që vendosni ta vizitoni.

Një tjetër destinacion, që vlen të merret në konsideratë është qyteti i vogël i Tepelenës, i cili ndodhet në Vjosë. Në breg të lumit ka disa kafene dhe restorante, ideale për t'u çlodhur dhe për të shijuar pamjen duke pirë një pije ose duke darkuar me ushqim të shkëlqyer.

Jashtë Tepelenës ka disa burime natyrore në shkëmbinj me ujë të pijshëm të freskët. Për të parë lumin nga afër mund të ecni edhe nëpër urën e Ali Pashës.

Stacionet e plazhit për vitin 2025, më 20 dhjetor afati i fundit për bizneset për të aplikuar

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro u bëri thirrje të gjithë subjekteve private që disponojnë struktura akomoduese pranë bregdetit, që të aplikojnë në E-Albania deri në datën 20 dhjetor.

Nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale Kumbaro bëri të ditur se "20 Dhjetori do të jetë afati i fundit i aplikimeve në E-Albania për të gjitha subjektet private që disponojnë struktura akomoduese pranë bregdetit, të certifikuar nga MTM të cilat dëshirojnë të menaxhojnë stacione plazhi gjatë sezonit veror 2025."

Aplikimi do të kryhet sipas kritereve të reja ligjore, ku plazhet do të mund të merren nën administrim të përkohshëm vetëm nga hotelet e vijës së parë ose në afërsi.

Të gjitha subjektet e interesuara mund të kryejnë aplikimin e tyre në portalin e-Albania duke kërkuar shërbimin "Aplikim për ushtrimin e veprimtarisë së stacion plazhi".

Hartat e plazheve u miratuan në fillim të muajit nëntor gjatë mbledhjes së Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik, ndërsa me rregulloren e re lirohen rreth 675 parcela plazhesh.

Aplikimi

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) njoftoi më 20 nëntor 2024 se janë hapur për bizneset e interesuara aplikimet të cilat do të qëndronin të hapura 30 ditë.

Sipas AKSHI-t, për të pestin vit radhazi, subjekteve u

krijohet mundësia të dërgojnë online kërkesën për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit gjatë sezonit turistik, të cilën e trajton Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sipas prioriteteve dhe kushteve të përcaktuara.

rimtarisë si stacion plazhi", përdoruesit e aksesojnë si biznes, duke plotësuar kërkesën sipas formatit standard. Përzgjidhet një nga numrat identifikues të stacionit të plazhit, sipas hartës digjitale të hapësirave të lejuara

rëndësishme për finalizimin me sukses të aplikimit:

- Plan-vendosja përkatëse e stacionit të plazhit, ku specifikohet numri i çadrave, duke mbajtur në konsideratë distancat e parashikuara në këtë



Në bazë të Vendimit të Qeverisë të miratuar pak javë më parë, u miratua rregullorja për kushtet dhe kriteret për përdorimin e hapësirës së plazheve nga subjektet private. Përparësi për stacione plazhi do të kenë vetëm strukturat akomoduese, pra hotelet e vijës së parë të bregdetit, si dhe ato që ndodhen afër saj.

Edhe pse duket si një procedurë e gjatë, aplikimi online për fazën e parë zgjat vetëm një minutë dhe çdo njoftim për të kaluar nga një hap në tjetrin i mbërrin subjektit aplikues elektronikisht në e-Albania.

Shërbimin elektronik "Kërkesë për ushtrimin e vep-

dhe ngarkohet dokumentacioni i nevojshëm, si:

- Plani i operimit për ushtrimin e veprimtarisë së stacion plazhi dhe strukturës shërbimi;

- Foto të jashtme të qarta të strukturës akomoduese, të cilat të identifikojnë strukturën akomoduese para/ në afërsi në raport me hapësirën e plazhit;

- Foto të qarta të hapësirës së plazhit (stacionit të plazhit) për të cilën po aplikohet

Pas kalimit me sukses të fazës së parë, aplikuesi së bashku me AKB-në dhe njësinë vendore njoftohen elektronikisht nëpërmjet portalit e-Albania, për hapjen e fazës së dytë, ku kërkohet plotësimi me dokumente specifike, shumë të

rregullore dhe sipërfaqen konkrete;

- Mandatpagesa vjetore e sipërfaqes së stacionit të plazhit nga ana e Njësisë së

Vetëqeverisjes Vendore, si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi;

- Vërtetimi i shlyerjes së të gjithë detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore.

Me përfundimin me sukses edhe të fazës së dytë, sipas AKSHI miratohet kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë së stacion plazhi, konfirmim ky që i shkon aplikuesit nëpërmjet e-Albania për t'u përmblyllur me nënshkrimin e kontratës nga 1 deri 5-vjeçare dhe lëshimin e certifikatën përkatëse.

"Ka shije dashurie" - Mediat botërore promovojnë qumështin e gomaricës nga jugu i Shqipërisë

"Qumështi i gomaricës ka shije dashurie," thotë fermerja gjirokastrite Fatiko Basha për rrjetin AFP, teksa bashkë me të tjerë në zonë thonë se mezi përballojnë rritjen e kërkesës, si për qumështin dhe djathin e tij.

Bashkëshorti i saj Veiz e përshkruan qumështin si flori i bardhë, i cili përdoret si në ushqim dhe në kozmetikë.

Çifti përdorin tashmë qumështin e gomaricës për të bërë djathë, gjizë dhe hurrë, por duhet të blejnë qumësht edhe nga fermerët fqinjë për të përballuar kërkesën.

Legjendat thonë se dhe Kleopatra bënte banjë në qumësht gomarice për të garantuar bukurinë dhe rininë e saj.

Por megjithëse dikush thotë se këto janë legjenda, Fatiko insiston se produkti i saj "shëron fëmijët nga i ftohti dhe është një kurë natyrore për problemet e rrugëve respiratore, alergjitë dhe forcon sistemin imunitar".

Ajo shihet që pastron sisët e një nëne gomaricë dhe e

duhet shumë dashuri, ndërsa cikli i prodhimit të qumështit të nënave nis kur këlyshi i tyre është rreth tre muajsh.

Dyshja Basha thonë se qumështi i gomaricës u bë i njohur gjatë sëmundjes Covid, dhe ata vendosën të sillnin gomerët në fermë, dhe më pas t'i shisnin në Shqipëri, Maqedoni e malin e Zi.

Ata kanë tani 30 gomarica e katër meshkuj që ushqehen në kullotat e rrëzë-maleve të Gjirokastrës.

Nga një gomaricë pritet vetëm gjysmë litër qumësht në ditë por më pas "floriri i bardhë" shitet për 50 deri në 60 euro litri, ndërsa djathi me shume se 1000 euro kilogrami.

"Kemi dhe kërkesa për djathë gomarice, që është i



përkëdhel për të tentuar të nxjerrë qumështin, ndërsa këlyshi i saj Xhoia që duhet të merrte qumështin e shikon me habi.

Fermerët thonë se që të marrësh qumësht nga gomarica

vështirë për t'u përgatitur", thotë bija e çiftit Xhiko Basha, e cila përgatit djathë gomarice për një restorant vendas në shtëpinë e saj pranë fshatit Lazarat, shkruan mes te tjerash rrjeti AFP.

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji janar 2025

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit janar 2025

Më 3, 4 janar - Dushi me teorësh kuadrantidësh. Quadrants është një shi mbi me-

Parashikimi i motit për muajin janar 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit, Temp. reale që ndjehet, Shiu, Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Contains daily weather data for Tiranë.


sataren, me deri në 40 meteorë në orë në kulmin e tij. Mendohet se prodhohet nga kokrrat e pluhurit të lënë pas nga një komete e zhdukur e njohur si 2003 EH1, e cila u zbulua në vitin 2003.

Gjysmëhëna do të përëndoje herët në mbrëmje, duke lënë qiej të errët për atë që duhet të jetë një shfaqje e shkëlqyer. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend i errët pas mesnate.

Më 10 janar - Venusi në zgjatimin më të madh lindor. Planeti Venus arrin zgjatjen më të madhe lindore prej 47.2 gradë nga Dielli.

Më 13 janar - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar.

Më 16 janar - Marsi në opozitë. Planeti i kuq do të jetë në afrimin më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli.



Treguesit mesatare klimatike gjatë muajit janar 2025

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastër. Lists various meteorological indicators across different cities.

Do të jetë më i ndritshëm se në çdo kohë tjetër të vitit dhe do të jetë e dukshme gjatë gjithë natës. Kjo është koha më e mirë për të parë dhe fotografuar Marsin.

Më 29 janar - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës.

muajit për të vëzhguar objektet të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Parashikimi i motit për muajin janar 2025

Muaji janar në Tiranë, do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Moti në Shqipëri në janar është shumë i ftohtë me temperatura ndërmjet 3°C dhe 10°C.

Parashikimi i motit për janar 2025 në Korçë (Zona e ftohtë)

Detailed weather forecast table for Korçë, including columns for temperature, precipitation, wind, and weather symbols.

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin janar 2025

Calendar table for January 2025 with columns for date, day, moon phases, and astrological signs.

duke arritur një mesatare prej 9,9 °C deri në fund të janarit.

Temperaturat e larta ditore do të jenë rreth 11°C, rrallë do të bien nën 7°C ose të kalojnë 16°C.

Temperaturat e ulëta ditore do të jenë rreth 1°C, rrallë do të bien nën -5°C ose të kalojnë 6°C.

Për referencë, më 2 gusht, dita më e nxehtë e vitit, tem-

peraturat në Tiranë, variojnë



zakonisht nga 18°C deri në 32°C, ndërsa në 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato variojnë nga 0°C deri në 11°C.

Zhvillimi i reve

Muaji anar në Tiranë, do të përjetojë në thelb mbulim të vazhdueshëm me re, me përqindjen e kohës që qielli do të jetë me vranësira ose kryesisht vranësira mbetet rreth 51% gjatë gjithë muajit.

Dita më e kthjellët e muajit është 2 janari, me kushte të



PËRFITO

NORMAT MË TË MIRA
TË INTERESIT



Depozita e Artë

- Hap depozitën **36 Muaj**
- Normë interesi deri në **4.5%** në Lekë dhe **3.5%** në Euro

Skano për
më shumë

